

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-25/12-06

Prishtinë, më 1 dhe 2 qershor 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 76 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit të foshnjës me qumësht të nënës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hulumtime gjeologjike;
8. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e z. Altay Suroy zëvendësministër të Drejtësisë dhe
9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2005.

1. Miratimi i rendit të ditës

Me propozimin e kryetarit, Kuvendi miratoi rendin e ditës, të propozuar për këtë seancë, me këto plotësime:

1. Miratimi i planit për dinamizmin dhe funksionalizimin e Kuvendit dhe
2. Rritja e numrit të anëtarëve të komisioneve funksionale.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 11, 12 dhe 15 maj 2006

Procesverbalet e seancave të mëparshme u miratuan me vërejtjen e deputetit **Ramadan Kelmendi**, ngase nuk ishte evidencuar diskutimi i tij për gjendjen në Universitetin e Prishtinës.

3. Miratimi i planit për dinamizmin dhe funksionalizimin e Kuvendit

Kryetari i informoi deputetët lidhur me planin që parashihte dinamizmin dhe funksionalizimin e punëve të Kuvendit dhe të trupave të tij punues.

Deputeti **Nait Hasani** (PDK) ngriti shqetësimin për rastin e Krushës së Vogël, i cili kishte ndodhur para një jave.

Atë ditë edhe një herë banorët e Krushës së Vogël, nënat, gratë dhe fëmijët jetimë kësaj radhe u gjuajtën me gazë lotsjellës dhe më të shtëna duke i tmerruar e kujtuar ditët më të vështira të tyre kur humbën më të dashurit e tyre, burrat e fëmijët nga 40 shtëpi shqiptare në Krushë të Vogël 114 meshkuj u morën, u kidnapuan u zhdukën dhe ende nga ajo ditë e 26 marsit 1999 nuk dihet për fatin e tyre nga vendësit e tyre serbë.

Në Krushë të Vogël kanë ardhur kriminelët në përcjellje të UNMIK-ut për t'i parë pronat e veta.

Ai kërkoi që Kuvendi të formojë një komision hetimor që të merret me rastin e Krushës dhe ta shpejtojë procesin e të pagjeturve.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi nga organet përgjegjëse për çështje të sigurisë informatë me shkrim për ngjarjen në Krush të Vogël.

Ai e përkrahu planin e reformave për dinamizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se incidenti në Krush të Vogël ishte një provokim i panevojshëm. Kuvendi duhet të informohet zyrtarisht për këtë incident.

Ajo shtoi se e përkrahu planin e reformave për punë e Kuvendit.

Jakup Krasiqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ngjarja në Krush të Vogël tregon dobësitë e sistemit të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë, të cilët duhet të reformohen. Kuvendi të formojë në komision hetimor për hulumtimin e ngjarjes në Krush të Vogël.

Ai përkrahu planin për dinamizmin dhe funksionalizimin e Kuvendit.

Teutë Sahatçija, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se i përkrah shqetësimet e parafolësve për ngjarjen e ndodhur në Krushë të Vogël.
Ajo e përkrahu planin e reformave për punën e Kuvendit.

Gjergj Dedaj, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim” tha se ngjarjet në Krushë të Vogël ishin një provokim. Kuvendi të informohet dhe të dal me një qëndrim për atë se çka ka ndodhur në Krushë të Vogël.
Plani i reformave për punën e Kuvendit duhet të jetë ë substancial.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6+, tha se mbështetë shqetësimet e parafolësve për ngjarjet në Krushë të Vogël.
Ai e mbështeti planin e reformave për punën e Kuvendit.

Kryetari tha se kemi dy propozime: a) Kuvendi të formojë Komision hetimor për ngjarjen në Krush të Vogël dhe b) Kuvendi të informohet zyrtarisht për ngjarjen në Krush të Vogël.

Sabri Hamiti tha se nuk duhet votohet për këto propozime pa u bërë konsultime paraprake ndërmjet grupeve parlamentare.

Nexhat Daci tha se ngjarja në Krush të Vogël është e dhimbshme kur kihet parasysh e kaluara jo e largët në këtë fshat. Duhet pasur kujdes para se të hidhet në votim ndonjë propozim lidhur me këtë ngjarje. As ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Drejtësisë nuk kanë që ë informuara për atë se çka ka ndodhur. Qeveria sa më parë duhet ta informojë Kuvendin për këtë ngjarje.

Xhavit Haliti kërkoi të mos votohet për asnjërin propozim lidhur e ngjarjen në Krushë të Vogël.
Kuvendi të vazhdojë me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Gain Koci propozoi që Kuvendi mos t’i miratoj ë seancë e sotme ndryshimet e propozuara ngase ka nevojë edhe për ndryshime dhe plotësime tjera.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit.

Kuvendi i miratoi këto amendamentet 1, 2 3, dhe 4.

Pastaj kryetari i hodhi në votim amendamentet ë tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----74;
Kudër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës më shumicë votash miratoi ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, secilin veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7.

Sabri Hamiti propozoi që amendamentet e tjera të votohen përnjëherë, ngase janë të ndërlidhura ndërmjet veti.

Jakup Kkrasniqi e përkrahu këtë propozim.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Sabri Hamitit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----47;
Kundër----- 4.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet prej 8 deri 61. rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----60;
Kundër----- 4.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----57;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi Ligjin për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë.

Kryetarët e grupeve parlamentare kërkuan që amendamentet e propozuara nga Komisioni Përgjegjës për këtë projektligj të votohen për një herë.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara 1-24. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----62;

Kundër-----2.

Pastaj kryetari e hodhi Projektligjin dhe amendamentet në tërësi në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----62

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi** Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti **Nimon Alimusaj**, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport – propozues i Projektligjit - e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga nënkryetari i Komisionit Nimon Alimusaj, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sala Ahmeti, Myrvete Dreshaj, Nuran Malta, Sabit Rrahmani, Genc Gorani dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 66;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport-Komision Përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit të foshnjave me qumësht të nënës

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Fadil Kryeziu**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri **Kryeziu** shpjegoi strukturën e këtij projektligji. Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Kryeziu**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nafije Berisha, Flora Brovina, Zylfije Hundozi, Teutë Sahatçija, Shpresa Murati, Ferid Agani, Behxhet Brajshori, Nekibe Kelmendi, Sabri Hamiti, Nurishahe Hulaj, Teutë Hadri dhe Alush Gashi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;
Kundër----- 9.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit të foshnjave me qumësht të nënës . Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale-Komision Përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, E'them Çeku, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Çeku shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Çeku, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Sala Berisha, Xhevdet Neziraj, Genc Gorani, Xhezair Murati, Ilmi Ahmeti, Behxhet Brajshori dhe Bajrush Xhemajli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 72;
Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për hulumtimet gjeologjike. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 13:20 minuta.

E premte, 2 qershor 2006

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 71 deputetë dhe e shpalli të hapur punën e saj.

9. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e z. Altay Suroy zëvendësministër të Drejtësisë

Kryesuesi kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare që të deklarohen për procedimin e kësaj pike, ngase Grupi Parlamentar i PDK-së ishte i mendimit se zëvendësministrat nuk duhet t'i emëroj Kuvendi, por Qeveria.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoi sqarime nga kryeministri dhe nga PSSP-ja lidhur me emërimin e zëvendësministrave. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së është i pranueshëm.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e mbështet propozimin e parafolësit të saj.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6+ kërkoi që emërimi i zëvendësministrit të Drejtësisë të shtyhet për seancën e ardhshme.

Kryesuesi konstatoi: me kërkesë të përfaqësuesit të Grupit Parlamentar 6+, propozues i kandidatit për zëvendësministër të Drejtësisë, emërimi i tij shtyhet për seancën e radhës.

10. Shqyrtimi i propozimvendimit të kryesisë së Kuvendit për rritjen e numrit të anëtarëve të komisioneve funksionale

Kryesuesi i informoi deputetët për propozimin e kryesisë, që me kërkesë të Grupit parlamentar "Për Integrim" që anëtarët e tij të përfshihen në komisionet funksionale i propozon Kuvendit që të rris numrin e anëtarëve të komisioneve funksionale nga 12 në 14, dhe atë si vijon:

- gjashtë (6) anëtar nga Grupi Parlamentar "Për Integrim" dhe dy (2) nga Grupi Parlamentar i PDK-së;
- tetë (8) anëtarë nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin për emërimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;

Kundër----- 6.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori

V E N D I M

Për rritjen e numrit të anëtarëve të komisioneve funksionale nga 12 në 14 anëtarë.

11. Shqyrtimi raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2005

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Haki Shatri, ta arsyetoj, para deputetëve të Kuvendit, raportin përfundimtar për buxhetin e vitit 2005.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Haki Shatri, në fillim tha se Ligji për buxhetin për vitin 2005 është miratuar më 2 muaj vonesë për shkak të zgjedhjeve të fundit të vitit 2004 dhe konstituimit të institucioneve qendrore në dhjetor 2004.

Nga të dhënat e bilancit të gjendjes së pasurive dhe të fondeve, më 31.12.2005 në vitin raportues vazhdoi konsolidimi i qëndrueshmërisë dhe i stabilitetit buxhetor. Ndryshimi negativ ndërmjet shpenzimeve të cilat ishin 696 milion euro dhe të hyrave të cilat ishin 628 milion euro është mbuluar nga rezervat e parasë në kesh në shumë prej 68 milion euro. Si rezultat rezerva e keshit më 31.12.2005 është 104 milion euro, këtu përfshihen edhe rreth 9 milion euro para të cilat janë si të hyra buxhetore të organizatave të caktuara buxhetore që gjithsej rezerva arrin në 114 milion euro. Kur kemi parasysh që në fillimi të këtij viti është realizuar me sukses një konferencë me donatorë për mbështetje buxhetore ku Kosovës i janë zotuar rreth 57 milion euro mbështetje buxhetore del se këtë vit dhe dy vitet pasuese Kosova nuk do të ballafaqohet me problemin e mungesës së mjeteve buxhetore. Plani i të hyrave është realizuar 98%, të hyrat janë realizuar në brendi, kanë shënuar rritje më dinamike se sa të hyrat në kufi, kjo ka ndikuar në fillimin e përmirësimit të strukturës së të hyrave fiskale. Janë dy burime të hyrash që nuk janë realizuar, e para, të hyrat vetjake të komunave janë realizuar vetëm 71%, pra 10 milion më pak se sa që janë parapa dhe e dyta, nuk janë realizuar të hyrat e parapara nga taksa për licencën e telefonisë, pra operatorit të dytë të telefonisë mobile.

Me Ligjin për buxhetin në vitin 2005 kufijtë e shpenzimeve buxhetore janë limituar në 744 milion e 881.000 euro, në këtë shumë janë përfshirë edhe 2 huadhënie të Qeverisë për KEK-un dhe Aeroportin në shumë prej 22 milion euro, kjo do të thotë që shpenzimet reale janë përcaktuar në kufijtë 722 milion e 881.000 euro. Shpenzimet buxhetore në vitin 2005 kanë qenë 696 milion e 121.000 euro duke përfshirë këtu edhe huan prej 22 milion euro, nëse zbresim huadhënien atëherë del se shpenzimet reale në vitin 2005 kanë qenë 674 milion e 121.000 euro ose 10% më pak se në vitin 2004 dhe po ashtu 10% më pak se në ndarje të buxhetit për vitin 2005. Karakteristikat esenciale të shpenzimeve në vitin 2005 është zvogëlimi global i shpenzimeve në krahasim me vitin 2004 dhe në krahasim me ndarjet e vitit 2005. Kursim përmbajtësor përmes zvogëlimit të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe kjo për 24% në krahasim me vitin paraprak dhe 10% në krahasim me ndarjet buxhetore 2005. Në asnjërën kategori të shpenzimeve nuk janë tejkaluar shpenzimet buxhetore të parapara me ligjin mbi buxhetin për vitin 2005.

Shpenzimet kapitale janë shpenzuar vetëm 87.5% ose kanë shënuar rënie për 22.7% në krahasim me vitin 2004.

Në vazhdim ministri Shatri foli për strukturën e shpenzimeve dhe për shpenzimet sipas organizatave buxhetore.

Naser Osmani, theksoj se do të diskutoj në emër të G/P të LDK-së por edhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit për buxhet dhe financa duke shtuar se Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës ka shqyrtuar aktualitetet fiskale dhe raportin e analizave dhe të aktiviteteve ekonomike për periudhën janar – dhjetor të vitit 2005, të hartuar nga njësia e raportimit fiskal e MEF-it.

Raporti i përpiluar nga MEF-i është më i kompletuar nga krahasim me vitet e kaluara dhe për t'u avancuar edhe më tutje në këtë drejtim MEF-i duhet që të nxjerrë udhëzime administrative sa i përket kësaj çështje. Pasqyra financiare për vitin fiskal 2005 në mënyrë të qartë na tregon bilancin e gjendjes së pasurive dhe fondeve duke përfshirë paratë e gatshme në bankë, paratë e gatshme në arkë, fondin e depozitave, fondin e privatizimit, fondi i cili nuk është në dispozicion të buxhetit e as në shërbim të ekonomisë Kosovare dhe për të cilat mjete duhet të ketë një raportim të ndarë dhe transparent nga institucioni përkatës. Në vazhdim kërkoj nga Qeveria që të përmirësojë procedurat për krijimin e bazës së të dhënave më të sakta, në mënyrë që të eliminohen përfituesit e tepërt në shojza. Kjo do t'i mundësonte Qeverisë që të zbatojë rekomandimin e Parlamentit për ndarjen e mjeteve edhe për 6 milion euro, siç e kemi thënë për ngritjen e pensioneve. Duhet që Qeveria të hartojë raport të veçantë për të gjitha mjetet që i janë ndarë AKM-së nga buxheti i Kosovës që nga fillimi në mënyrë të hollësishme që të pasqyrohen se a janë shpenzuar ato mjete ashtu siç janë destinuar dhe në fund duke mos u ndalur te kategoria e shpenzimeve kapitale.

Jakup Krasniqi, në cilësinë e kryetarit të Grupit parlamentar të PDK-së, tha se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është e obliguar të paraqesë raport vjetor financiar deri më 21 mars të vitit vijues. Në rastin tonë kjo po ndodh në fillim të muajit qershor 2006, d.m.th më se 2 muaj vonesë. Raportet e auditorit gjeneral, sidomos ato për vitin 2005, kanë shpalosur shumë keqpërdorime të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, por raporti i Qeverisë nuk e thotë asnjë nga këto gjëra që kaq shumë flitet dhe shkruhet sot në Kosovë. Me keq shfrytëzimin e buxhetit nuk kanë mbetur prapa Qeverisë as Kuvendi e as Presidenca e Kosovës, si dhe komunat. Prijnë sidomos komunat e mëdha prej nga kanë ardhur disa anëtarë të ish- kabinetit dhe të kabinetit të tashëm. Raportet e të gjitha njësive buxhetore u mungon transparenca, pozicionet janë të paraqitura në mënyrë sintetike, analitike mungon në tërësi si për të hyrat ashtu edhe për të dalurat. Mënyra e tillë e raportit na shtyn të mendojmë dhe jemi të bindur se ka për qëllim fshehjen e vjedhjeve buxhetore dhe të veprimeve të tjera të paligjshme. Brenda këtyre pozicioneve nuk ka analitike e cila do t'u mundësonte tatimpaguesit për të parë si janë dhe ku janë shfrytëzuar paratë e tyre. Kjo nuk u mundësohet as deputetëve të Parlamentit. Një formë e tillë e raportimit e pamundëson skajshmërisht transparençën, i mbulon të gjitha keq shfrytëzimet dhe vjedhjet që i janë bërë buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të vitit 2005 është se dominojnë të hyrat në kufi 443 milion euro, në të hyrat e brendshme ka ngecje, në vend të 34.800.000 euro janë grumbulluar 24 milion, pra mbi 10 milion euro më pak. Në krahasim me vitin 2004, në vitin 2005 investimet kapitale janë zvogëluar për 42 milion euro. Ky raport është dëshmi tjetër që Kuvendi duhet t'ia marrë votëbesimin këtij kabineti qeveritar sa nuk është bërë tepër vonë.

Mazllum Kumnova, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se që në fillim mund të konstatojmë, se menaxhimi i buxhetit nga institucionet tona ka shënuar një përmirësim të dukshëm në krahasim me periudhën e kaluar. Po ashtu ky raport, për herë të parë, ka

pasqyruar edhe aspekte financiare të privatizimit, por jo edhe të AKM-së. Rritja e të hyrave për 4.3 dhe ulja e treguesit të shpenzimeve për 7.1% janë një shenjë inkurajues në njërin anë ,derisa përballemi përsëri me deficitin për 68 milion në anën tjetër. Po ashtu edhe përqindja 97.9 e hyrave të grumbulluara janë shenjë e një buxheti stabil edhe pse gjithnjë mbetet në kuotën e një treguesi të varfërisë së skajshme. S'ka dyshim se mbetet të diskutohet paaftësia administrative komunale për grumbullimin e tatimeve që janë ende larg realizimit sipas planifikimit, pra mbetet të punohet në krijimin e një administrate të përgjegjshme në grumbullimin dhe shfrytëzimin me efektivitet të parave publike. Në anën tjetër , grandet nëpër komuna shumë të diskutueshme për kriteret, kryesisht shpenzohen për paga dhe mëditje. Kjo do të thotë se jemi larg asaj strategjie që taksapaguesit t'i kthehet ajo që i merret në shërbim dhe shërbesa ndaj qytetarëve me investime të nevojshme në favor të gjithë qytetarëve. Pa dyshim mbetet shumë për të bërë në drejtim të një menaxhimi të shëndetshëm të financave publike, për të cilin vërehet një angazhim më i shtuar i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa , sidomos në këtë vit.

Nazim Jashari në emër të Grupit Parlamentar Ora, në fillim tha se është një ngjarje e rëndësishme për Kuvend kur diskutohet, qoftë për miratimin e buxhetit dhe që ndodh zakonisht në fund të çdo viti kalendarik, qoftë kur diskutohet për mënyrën se si është shpenzuar buxheti. Fatkeqësisht në Kuvend kjo nuk është ngjarje , sepse qasja jonë ndaj parasë publike është e tillë çfarë unë si deputet ose grupi parlamentar të cilit i takoj, kemi dëshirë të ndryshojë dhe të jetë më shumë përgjegjësi, që nga ato para publike të kemi sa më shumë shërbime dhe të mira për qytetarët e Kosovës. Ajo nuk mund të ndodhë, sepse thjesht raporti i forcave në këtë Kuvend jo me seriozitet e bën të pranueshëm dhe vetëm një frymë të mundshme të punës së këtij Kuvendi. Raporti në Kuvend është dorëzuar me 12 prill, nuk është shumë, janë 12 ditë, por janë 12 ditë shkelje e afateve, janë 12 ditë të shkeljes së ligjit për të cilat në një shoqëri normale demokratike nuk do të ishte marrë ministri në përgjegjësi nga opozita, por do të ishte marrë në përgjegjësi nga partia e vet, por kjo te ne nuk ndodh. Në vazhdim ai tha se raporti që na është dhënë është një raport tejet i përgjithshëm, ne në komision kemi diskutuar në parim për këtë, kryetari i Komisionit e tha që është miratuar njëzëri. Më duhet ta përgënjeshtroj, nuk është miratuar as nuk është votuar fare për të . Kërkohej nga kjo ministri dhe nga kjo qeveri që të bëjë ndryshim në mënyrën e vjeljes së të hyrave.

Ferid Agani tha se Grupi Parlamentar për Integrim konsideron se ky dokument ka mund të jetë më komplet, ka mund të ketë një komponent edhe më të theksuar analitik në bazë të të cilit ne si deputet do të mund të nxjerrim përfundime më gjithëpërfshirëse për efektivitetin e menaxhimit financiar të buxhetit në vitin 2005. Në vazhdim ai u përqendrua në organizatën buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë, duke tërhequr vërejtjen në disa pika. Mënyra e shfrytëzimit të buxhetit të vitit 2005 është vërtetim shumë i qartë i lëshimeve të mëdha në procesin e përpilimit të buxhetit për sektorin e shëndetësisë. Konsideroj se në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave mungon ndjeshmëria për specifikat e sektorit të shëndetësisë dhe në një mënyrë parimet të cilat vlejné për sektorët e tjerë të jetës shoqërore bëhen përpjekje të përgjysmohen edhe për sektorin e shëndetësisë dhe në këtë mënyrë shkaktohen vështirësi shumë të theksuara në funksionimin e shërbimeve brenda këtij sektori, duke i elaboruar me shembuj konkret. Në vazhdim ai tha se duhet të nxjerrim mësim nga gabimet dhe të mos përsëriten këto, të bëhet redistribuimi i mjeteve të pakta financiare të cilat ekzistojné dhe në këtë mënyrë të mundësohet konsolidimi i shërbimeve shëndetësore.

Në debat morën pjesë deputetët: Nazhije Doçi, Demir Limaj, Ragip Zekolli, Safete Hadërgjonaj, Ramadan Kelmendi, Gani Koci, Melihate Termkoll, Bajrush Xhemajli, Behxhet Brajshori, Xhevdet Neziraj, Selviqe Halimi, Hatixhe Hoxha. Diskutimet e deputetëve janë pjesë integrale të transkriptit të seancës plenare.

Pas debatit, **ministri Haki Shatri** dha disa sqarime dhe përgjigje në pyetjet e deputetëve.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së z. Alush Gashi tha se debati i sotëm për buxhetin fatmirësisht demonstroi që si institucione demokratike dhe si Kuvend kemi ardhur në atë nivel që të merremi me buxhet të debatojmë dhe bëjmë përpjekje maksimale që buxheti i Kosovës të jetë sa më i lartë që të shpenzohet sa më mirë dhe në interes të qytetarëve të Kosovës dhe gjatë këtij procesi të ketë transparencë të plotë institucionale.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet rekomandimin e Komisionit të Buxhetit dhe të Financa dhe fjalën hyrëse në fillim të kësaj seance, e cila demonstroi se në buxhetin e Kosovës nuk ka tejkalime buxhetore. Si grup parlamentar kërkojmë nga Ministria dhe Qeveria në tërësi një angazhim të shtuar në mbledhje të taksave dhe në ndërrimin e raportit të themelimit të buxhetit në mes të asaj që arrihet në doganë të asaj që vilet nga tatime në përgjithësi.

Si pozitë nga ministri kërkojmë që gjitha analizat të cilat i kërkon opozita me kohë dhe në mënyrë transparente t'i ofroni. Në ditën e votimit të Qeverisë kemi garantuar korrektësi dhe transparencë institucionale dhe i kemi të gjitha arsyet që t'i qëndrojmë atij vendimi politik. Kërkojmë që pas këtij përfundimi të debatit të merret vendim në kuadër të Rregullores së punës duke shtuar se jemi të gatshëm ta votojmë këtë buxhet.

Kryesuesi Xhavit Haliti: Në përputhje me Rregulloren e punës dhe me kërkesën e Ministrisë së Financave, dhe të Grupit Parlamentar e hedh në votim miratimin e Raportit të Ministrisë së Ekonomisë e të Financave.

Kryesuesi konstaton se në sallë janë prezent 69 deputetë, do të thotë ka forum për të votuar. Rezultati i votimit:

Për.....52;

Kundër..... 21.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Raportin Përfundimtar për Buxhetin e vitit 2005.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale